



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr. _____

Datë: 05.10.2017

Komisioni i Autoritetit Kosovar i Konkurrencës, mbështetur në nenin 28 (1.2) nenin 29 paragrafi (1), nenin 54, paragrafi (2) me nën paragrafin 2.3, nenin 3 paragrafi (1.8), nenin 34 nenin 35 paragrafi (5) i Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare nr.88/25), Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare në bazë të dyshimeve se ka fiksime të çmimeve ka monitoruar tregun në sektorin e grumbullimit, përpunimit dhe shitjen e grurit në Kosovë, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datën 05.10.2017 merr këtë:

K O N K L U Z I O N

- I. Gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun relevant, bazuar në dispozita e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. konstatohet se nuk ka argumente për Fillimin e Procedurës Hetimore në sektorin e grumbullimit, përpunimit dhe shitjen e grurit në Kosovë.
- II. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, do të vazhdojë edhe më tutje monitorimin analizimin e tregut në këtë sektor.

A R S Y E T I M

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare në bazë të dyshimeve se ka fiksime të çmimeve në sektorin e grumbullimit, përpunimit dhe shitjen e grurit në Kosovë, nga data 17 - 21 korrik 2017, ka monitoruar tregun relevant dhe ka inspektuar disa operator ekonomik të cilët merren me këtë veprimtari si dhe Shoqatën e Mullisëve të Kosovës.

Përfaqësuesit e kompanive dhe Shoqata e Mullisëve të Kosovës gjatë monitorimit kanë deklaruar se nuk ka marrëveshje për fiksimin e çmimeve, e çmimet përcaktohen duke përcjellë berza të ndryshme rajonale dhe botërore.

Çmimet që u paguhet bujqve apo prodhuesve të grurit si dhe miellit e krundet janë:

Nr.	Produkti	Njësia	Çmimi
1	Gruri	1kg	0.15-0.16 cent
2	Krundet	1 kg	0.09-0.10 cent
3	Mielli	100 kg	22-25 euro

Grumbullues të miellit në Kosovë, në vitin 2017 janë:

Nr.	Numri i përgjithshëm i kompanive në Kosovë	Numri i kompanive që punojnë gjatë tërë vitit	Numri i kompanive që punojnë në sezone
1	96	20-25	71

Sipas të dhënave nga Mullisët, Kosova nuk ka rezerva të miellit. Në deklaratimet e tyre ata kanë shprehur se ndërmarrja **M & Sillosi** ka përqindjen më të lartë në treg krahasuar me konkurrentët të cilët merren me këtë veprimtari. Kjo kompani ka kapacitete dukshëm më të avancuara në kapacitetet humane e teknologjike në raport me kompanitë dhe ndërmarrjet tjera në Kosovë e rajon, edhe sa i përket grumbullimit, blojës dhe prodhimit të miellit të të gjitha llojeve dhe krundeve. Kjo kompani është liderë dhe udhëheq me tregun kosovar për shërbime me shumicë dhe pakicë të grumbullimit, prodhimit dhe furnizimeve me miell.

Disa nga përfaqësuesit e Mullisëve kanë shprehur shqetësimet e tyre se miellin 25 kg, në disa super markete të mëdha janë duke e shitur me çmim prej 3.99 euro, ky çmim është duke na paraqitur problem sepse janë duke e shitur nën kosto. Nëse shteti nuk e përkrahë prodhuesin vendor dhe nuk vendos masa mbrojtëse në importe atëherë ne do të detyrohemi t'i mbyllim mullisët tanë, përpunuesit e grurit dhe bujqit janë në krizë,. Sipas deklaratimeve të tyre se 90% e mullisëve nuk mundën t'i mbulojnë shpenzimet e operimit të ndërmarrjeve.

Në Kosovë sasia e prodhimit të grurit krahasuar me vitin e kaluar është ma e vogël, çdo vit bujqit janë duke mbjellë grurë ma pak për arsye se nuk ka llogari e profit, grumbulluesit e grurit për 100 kg grurë buqëve ua ndalin 18% të sasisë për shërbime kurse 30% e krundeve i kthehet bujkut, çmimi i miellit të importuar nga Serbia në tregun tonë kushton me 0.25 cent kg, sipas tyre prodhimi vendor i grurit e mbulon 50% të konsumit në Kosovë.

Pronarët e kompanive kanë deklaruar se kemi kërkuar masa mbrojtëse në importe nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë sepse duhet të mbrohet prodhimi vendor, e sipas tyre çmimi i importit mund të ngritet kur të konsumohet prodhimi vendor por nuk mund të jetë ngritje e lartë, Çmimin është duke e diktuar edhe importi i miellit e grurit, krundeve për shkak se gruri dhe krundet kanë TVSh 0 %, në doganë kurse mielli 8 %.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas analizës dhe krahasueshmërisë së çmimeve të rajonit për grurin dhe miellin është pothuajse i ngjashëm me Kosovën. Kryesisht vendet e rajonit bazohen në berzën e Beogradit dhe Parisit, etj. Grumbulluesit dhe përpunuesit e miellit në Kosovë e përcjellin çmimin duke u bazuar në berzën e Beogradit dhe Parisit, kjo mënyrë e përcaktimit të çmimit të grurit dhe miellit aplikohet edhe në Kosovë.

Në bazë të analizës Autoriteti Kosovar i Konkurrencës vlerëson se nuk vërehet ndonjë koordinim i mullisëve për të përcaktuar çmimin blerës, shitës apo ndonjë kusht tjetër tregtar të grurit dhe miellit në Kosovë, në raport me bujqit dhe në mes tyre.

Ka elemente të ndryshme që paraqiten në tregun përkatës me ankesa të ndryshme të Mullisëve që kemi vizituar mirëpo nga konstatimi del se nga këto shqetësime të tyre nuk përbëjnë shkelje ligjore sepse konkurrenca dhe inovacioni i subjekteve që operojnë në këtë nivel të tregut është brenda parametrave të lejuar të konkurrencës lojale.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka vërejtur se subjektet që operojnë në këtë treg e shohin njëri tjetrin si konkurrent dhe assesi si bashkëpunëtor në ndonjë marrëveshje. Nga takimet kemi vërejtur se ata kanë mjaftueshëm njohuri dhe vetëdijesim për rregullat e një tregu të lirë e konkurrues dhe në bazë të kësaj ata duket se janë konkurrent dhe inovativ në treg.

**KOMISIONI
AUTORITETIT KOSOVAR I KONKURRENCËS**

(_____)
Valon PRESTRESHI
Kryetar

(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Ahmet KRASNIQI	Fatime HAZIRI	Muhamed KRASNIQI	Shaqir MORINA
Zv. Kryetar	Anëtare	Anëtar	Anëtar

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- *Arhiva*
- *Publikohet në web faqen e Autoritetit*